



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PATOS
DREJTORIA E POLITIKAVE DHE E MONITORIMIT TË SHËRBIMEVE

MIRATOHET
KRYETARE
RAJMONDA BALILAJ

DETYRË PROJEKTIMI

OBJEKTI: RIKONSTRUKSIONI I SHKOLLES “MUHAMET SHEHU” DHE NDËRTIM PALESTRE.

VENDNDODHJA: LAGJA “NAFTETARI” BASHKIA PATOS.

QELLIMI I HARTIMIT TE PROJEKT PREVENTIVIT TE OBJEKTIT:

Te behet projekt preventivi i zbatimit per rikonstruksionin e objektit SHKOLLA 9-VJECARE “MUHAMET SHEHU”, LAGJA “NAFTETARI” Bashkia Patos me qellim nderhyrjen per perforcimin e konstruksionit mbajtes te objektit dhe permiresimin e anes funksionale, arkitektonike dhe mjedisore te ketij objekti.

A-VENDODHJA E OBJEKTIT.

Objekti ndodhet ne Lagjen “NAFTETARI”, Bashkia Patos .

B-PERSHKRIMI I GJENDJES SE OBJEKTIT EKZISTUES.

Godina e kesaj shkolle eshte me tre kate dhe e ndertuar rreth viteve “60 eshte me themele te vazhduara me gure, me mure me tulla me nderkat solete dhe e mbuluar me cati.

I gjithë objekti është i suvatuar me llac te perzier, me dysHEME me pllaka gres me dritare dhe dyer druri.

Objekti ka nje territor te pasistemuar ne kuota dhe ka te pazgjidhur disiplinimin e ujrave siperfaqesore, te siperfaqeve te gjelberuara, sheshe, mure rrethues, rrugica etj.

Objekti ka siperfaqen rrotull tij e thurur pjeserisht me mure me blloqe betoni dhe pjeserisht me kangjella metalike (pjesa jugore).

C-KAPACITETI I NUMRIT TE NXENESVE

Aktualisht në këtë shkollë frekuentojne rreth 360 nxenes dhe 27 mësues.

Duke mare parasysh shtesen kapaciteti per 25 vjet do te jete rreth 500 nxenes duhet te meret parasysh ne projektimin e klasave te shkolles.

D-PROBLEMET QE KA OBJEKTI

- Ka plasaritje te disa mureve te cilet kerkojne nderhyrje per te rritur aftesine mbajttese te tyre.
- Kane dale jashte funksionit nyjet higjeno sanitare dhe nuk plotesojne nevojat numrin e nxënësve qe do fekuentojnë keto ambiente.
- Nuk funksionon sipas atandarteve dhe ka probleme ne rrjetin elektrik.
- Ka problem me rrjetin e furnizimit me uji, stacionin e pompimit, vendosjen e depozitave dhe rrjetin shperndares.
- Ka te amortizuara dyert dhe dritaret
- Ka probleme te suvatimeve te brendeshme.
- Shkolla nuk ka te instaluar rrjetin e internetit.
- Nuk ka te instaluar rrjetin e kamerave te sigurise.
- Ka probleme te rrjetit te kanalizimeve dhe te pusetave shimbledhese dhe pusetave te ujrave te zeza.
- Eshte ipasistemuar ambienti jashtem.

E-PUNIMET DO TE KRYHEN NE OBJEKT

Nderhyrje ne konstruksionin e objektit

Ne projekt preventivin e zbatimit te objektit qe do te hartohet nga ana juaj te parashikohen:

- Evidentimi i plasaritjeve te mureve nderhyrja per permiresimin e konstruksionit mbajtes te godines.
- Zgjidhja e ambientit te palestres duke shfrytezuar nje pjese te siperfaqes së territorit përreth godinës .
- Nderhyrja per prishjen e mureve ndares, korigjimin e tyre dhe adaptimin e ambjekteve per tu pershtatur per klasa brenda normativave.
- Rindertimin e catise së shkolles e cila do te do te zgjidh hidroizolimin, termoizolimin dhe arkitekturen e objektit.
- Ndertimi i rrjetit elektrik te ri
- Zevendesimi i sistemit hidrosanitar te ri perfshi te gjitha pajisjet e domosdoshme
- Korigjimi dhe suvatimi i gjithe ambienteve
- Ndertimi i shtresave te dyshemese me pllake gres importi
- Vendosja e dyer dritareve
- Ndertimi i rrjetit inxhinierik:
(ngrohje, elektrik, ujesjelles, kanalizime, internet, kamera sugurie)

F-PALESTRA

Te parashikohet ndertimi i palestres se re per shkollen.

G-CATIA

Catia do te jete me lende druri te stazhionuar dhe mbulese me tjegulla importi

Mbi ristelat e tjegulave ,nen tjrugulla do te vendoset nenshtrese per hidro dhe termoizolimim e objektit.

H-DYER DRITARE

-Dyeret e ambjenteve hidrosanitare do jene duralumil dhe dyert e klasave do te jene tamburato

- Zevendesimi i dyer dritareve me prodhime te reja dhe brenda kushteve teknike(ne gjeresi dhe lartesi)

- Dritaret do te jene dural me dopjo xham

INSTALIMET ELEKTRIKE

Rrjeti i lidhjes me energji do te llogaritet ne funksion te hapesirave te drites se sallave me rrjet tre fazor qe do te sherbeje per ndricimin e objektit si dhe perfurnizimin e kabineteve, te laboreve ,te kaldajes, dhe te stacionit te pompimit .qe do te instalohen ne object.

Te mendohet vendosja e nje gjeneratori per raste emergjente.

Te parashikohet vendosja e ndricuesve decorative ne territorin e siperfaqes qe do te sistemohet para shkolles ku te sigurohet ndricimi ne territor

I-SUVATIMET

Suvatimet e brendeshme do te jene ma llac te perzier ,me fino dhe do te lyhen me boje hidromat cilesi e pare.

Suvatimi nga jashte do te jete me grafiato dhe I bojatisur me boje ‘AKRILIK”cilesi e pare

K-SHTRESAT E DYSHEMEVE

Shtresat e dyshemese pas prishjeve te tyre do te nivelohen me llac cemento mbi te cilen do te vendoset shtresa e kollit dhe e pllakave gres me dimensione 60x60 cm

L- NYJET HIDROSANITARE DHE LIDHJET ME RRJETIN E UJESJELLESIT DHE KUZ.

Te behet dhe pershtaten nyjet hidrosanitare per te dy katet duke mos harruar hidroizolimim e siperfaqeve te tyre para shtrimit te pllakave si dhe stukimi me kujdes i tyre.

Per venien ne shfrytezim te objektit te projektohet:

-rrjeti I lidhjes me uje nga pusi qendodhet ne territorin e objektit perfshi stacionin e pompimit,rrjetin e brendshem,depozitat e ujit etj.

-Permiresimi lidhjes me kanalizime te ujrave te zeza(dimensione,thyerje te tubove,permiresim puseta

Projektet e linjave te mesiperme te jene ne flete te vecante secila.

M-SISTEMI I NGROHJES QENDRORE

Objekti do te behet me ngrohje qendrore me lende djegese nafte duke ruajtur parametrat e distancave nga depozita ne objekt.

Kaldaja do te vendoset ne podrumin e objektit

Vendosja e radiatorëve te vendosen ne te gjitha ambientet.

-Te behet ne flete te vecante projekti i mbrojtjes kundra zjarrit

P-INSTALIMET PER LIDHJEN ME INTERNET DHE KAMERAT E SIGURISE

Objekti do te kete te instaluar rrjetin e internetit per te gjitha ambientet

Ne objekt do te vendosen kamerat e sigurise per vrojtimin brenda dhe jashte ambientit

Q-THURJA E OBJEKTIT.

-Ne projekt preventivin e zbatimit te parashikohet prishja dhe rindertimi i murit rrethues dekorativ me zgara netalike te inkastruara ne kolonat beton arme ne distance 2.5-3m larg nga njera tjetra.

Gjate projektimit te mendohet lidhja me rrugen ne perendim te shkolles.(kanalizime per sistemimin e ujrave sipërfaqesore,trotuare,peme decorative etj

R-SISTEMIMI I JASHEM

Te parashikohet sistemimi i territorit te jashtem te shkolles duke menduar qe te jene te ndara pjesa qe do te perdoret nga kopeshti dhe pjesa qe do te perdoret nga shkolla.

Te parashikohen sipërfaqe te gjelberuara,vendosje stolash,rrugica dhe minisheshe decorative dhe ne territorin qe do te perdoret nga grupi parashkollor ninikend lojnash(paralele,lisharse,lodra te ndryshme etj.

Te parashikohen vendosja e koshave te vegjel per mbeturinat urbane .

S-GRAFIKU I PUNIMEVE

Grafiku i punimeve te behet i detajuar per punimet e prishjeve te ndertim montimeve dhe te pajisjeve qe do te parashikohen ne object

T-TE TJERA MBI DEKUMENTACIONIN

Projekti i zbatimit te objektit do te na dorezohet ne menyre elektronike dhe i printuar ne dy kopje dhe te perfshije:

a)Plan rilevimin e parceles dhe e objektit ekzistues

b)Planimetrite e kateve te objektit prerjet terthore dhe te gjitha detajet e domosdoshme per zbatimin e projektit me ndryshimet perkatese te dimensioneve te klasave.

Projekti i ndryshimeve te mureve.

Projekti ndryshimeve apo permiresimeve konstruktiv,detaje

Projekti elektrik

Projekti hidraulik

Projekti i instalimeve te internetit

Projekti i sistemit te ngrohjes

Projekti i murit rrethues dhe sistemit te sipërfaqes rrotull shkolles

Projekt mobilimi

Projektet arkitektonike ne pamje dhe aksonometri

c)Projekti te hartohet ne dy kopjo ne format “A-3” dhe njekoheisht te dergohet ne forme elektronike

d)Per preventivimin e punimeve do te merren cmimet nga manuali ne fuqi(manuali1,2,3,4-2016)

e)Per ato zera qe nuk perfshihen ne manualin ne fuqi te hartohen analizat e cmimeve dhe ti bashkelidhen preventivit te punimeve qe do te kryhen

Per permiresimin e metejshem te projektit te,apo uljen e kostos se punimeve qe do te kryhen jemi te gatshem te bashkepunojme me ju ne cdo etape te hartimit te ketij projekti.

Duke ju falenderuar per bashkepunimin,

Hartoi:000

Ing.Agim LISI.